

## **ANEKS 4**

### **Për funksionet e transferuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore**

#### **1. Konviktet e arsimit parauniversitar**

Në transfertën e vitit 2023, disa bashkive u janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

#### **2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale**

Në transfertën e vitit 2023 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, “Opera Della Madonnina Della Grappa”, Shkodër, “Besa” Vau i Dejës, “Horizont”, Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qendra.

#### **3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)**

Në transfertën e vitit 2023 të bashkive, është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Brendshme duhet t’u dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2023, në zbatim të vendimit nr. 624, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

#### **4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar**

Në transfertën e vitit 2023, njësitë të vetëqeverisjes vendore u janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2023, në zbatim të VKM nr.465, datë 06.07.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në Arsimin Parauniversitar” të ndryshuar”.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

#### **5. Rrugët rurale**

Në transfertën e vitit 2023, njësitë të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

#### **6. Administrimi i pyjeve**

Në transfertën e vitit 2023, njësitë të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2023, në zbatim të vendimit nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar”.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

#### **7. Ujitja dhe Kullimi**

Në transfertën e vitit 2023, njësitë të vetëqeverisjes vendore u është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Në tabelën nr.3, të ligjit vjetor të buxhetit, është pasqyruar edhe efekti i rritjes së pagave për këtë funksion për vitin 2023, në zbatim të vendimit nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar”.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

## **8. Klubet sportive shumëportëshe , “Partizani” dhe “Studenti”**

Në transfertën e vitit 2023, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për shpenzime për personelin dhe për shpenzime operative për klubet sportive shumëportëshe “Partizani” dhe “Studenti”. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.